



INFORMATË BAZIKE:

Lajmëruesi i Dezinformatave – Monitorimi i Mediave Ruse është raport mujor i lajmeve që përmbajnë dezinformata dhe keqinformime që e vejnë në shënjestër Kosovën, dhe që janë të botuara në mediat ruse në gjuhën angleze dhe serbe

PËRKRAHUR NGA:



Londër, Mbretëri e Bashkuar

VËREJTJE:

Pikëpamjet e paraqitura në këtë publikim janë vetëm të Institutit Kosovar për Hulumtime dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED)

KONTAKTI:

Instituti Kosovar për Hulumtime dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED)

Rr. Major Mehmet Bushi, H.III/1
10 000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 (0)38 542 778
Web-site: www.kipred.org
Email: info@kipred.org

LAJMËRUESI I DEZINFORMATAVE PËR KOSOVËN

MEDIAT RUSE

DHJETOR 2020

HYRJE

Lajmëruesi i Dezinformatave për Kosovën: Monitorimi i Mediave Ruse synon t'u kundërvihet dezinformatave që e kanë në shënjestër Kosovën, përmes monitorimit në bazë mujore të botimeve të përzgjedhura mediale që botohen në Rusi, si në gjuhën angleze, ashtu edhe në atë serbe. Mediat e përzgjedhura në gjuhën angleze janë Russia Today, Sputnik, Meduza, Russia Insider, TASS, The Moscow Times, Newsfront, Unz, The Duran dhe Pravda Report, ndërkaq, në gjuhën serbe është Sputnik Serbia. Pos kësaj, Lajmëruesi i Dezinformatave për Kosovën i monitoron edhe lajmet, dokumentet dhe deklaratat që kanë të bëjnë me Kosovën, të lëshuara nga Kremli dhe Ministria Ruse e Punëve të Jashtme.

Gjatë dhjetorit 2020, Sputnik International i ka botuar 2 lajme, TASS-i 1, Unz-i 1, Russia Today 2, Russia Insider 1, The Moscow Times 1, ndërsa Sputnik Serbia i ka botuar 135 lajme që drejtpërdrejt apo në mënyrë të tërthortë kishin të bënin me Kosovën. Ndërkaq, Newsfront, Meduza, The Duran dhe Pravda Report nuk e kanë botuar asnjë lajm që kishte të bënte me Kosovën. Nga ana tjetër, gjatë kësaj periudhe monitoruese, Kremli e kishte 1, dhe Ministria e Jashtme Ruse 5 postime lidhur me Kosovën në ueb-sajtet e tyre.

Për shkak të numrit të madh të artikujve me përmbajtje dezinformuese të lëshuara nga këto media, në këtë botim janë analizuar vetëm artikujt me përmbajtjen dezinformuese më flagrante. Dezinformatat e botuara kanë synuar t'ia shkatërrojnë themelet shtetësisë së Kosovës duke u përpjekur të tërhiqnin paralele midis pavarësisë së Republikës së Kosovës dhe aneksimit ilegal të Krimesë. Për më tepër, këto media kanë prirje që Kosovën ta paraqesin si një shtet që i shfuqizon të drejtat themelore, sundimin e ligjit, dhe funksionimin e institucioneve demokratike. Artikujt e përzgjedhur po ashtu synojnë ta shtrembërojnë të vërtetën për të kaluarën, duke i mohuar krimet dhe mizoritë e Serbisë në Kosovë gjatë viteve 1990, si dhe duke i paraqitur serbët si viktime gjatë luftrave të zhvilluara me qëllim të barazimit të viktimës me agresorin.

DEKONSTRUKTIMI I DEZINFORMATAVE TË DETEKTUARA

Lajmërim i Dezinformatës 1

Titulli: Konferenca vjetore për shtyp e Vladimir Putinit, **Presidenti i Rosisë, 17 dhjetor 2020**¹
kommentuar nga **Sputnik Serbia, 17 dhjetor 2020**²

Artikulli e transmeton deklaratën e Presidentit të Rosisë, Vladimir Putin, gjatë konferencës vjetore të shtypit. Putini pretendon se “Në Kosovë, ishte parlamenti ai që e mori vendimin, dhe ju e bletë këtë, duke thënë se kjo është mënyra e duhur për të ecur, çdo gjë është mirë dhe demokratike. Në Krime, njerëzit erdhën në vendvotime dhe votuan në një referendum, por për ndonjë arsye, juve kjo nuk ju pëlqeu. Më lejoni t’ua përkujtoj se demokracia është sundim i popullit, dhe ju duhet ta pranoni këtë, ose ta ndërprisni shfrytëzimin e kësaj shprehjeje fare. Krimeasit janë duke u përballur me sanksione. Për çfarë ua keni futur ato sanksione? Nëse ata kanë qenë të aneksuar, ata nuk mund të fajësohen. Pse duhet që ata të ndëshkohen?”

Dekonstruktimi i Dezinformatës: Fakte dhe Shifra

Presidenti i Rosisë, Vladimir Putini, u përpoq të bënte krahasime midis Republikës së Kosovës dhe Krimesë. Putini është përpjekur vazhdimisht ta përligjte aneksimin e Krimesë nga ana e Rosisë në vitin 2014, me “precedentin” e pavarësisë së Kosovës. Lidhur me këtë, ai e justifikon referendumin ilegal që e mbajti Krimea para pushtimit nga forcat ushtarake të Moskës, duke e konsideruar atë, në një mënyrë ironike, si një themel ligjor për aneksimin nga Rusia. Pos kësaj, Putini e ka konsideruar pavarësinë e Kosovës si një aneksim, gjë kjo që është bërë pas pushtimit nga NATO.³

¹ Konferenca vjetore e shtypit e Vladimir Putinit, <http://en.kremlin.ru/events/president/news/64671>.

² Путин: Запад „прогутао“ Косово, а Криму увео санкције [Putini: Perëndimi “e gëlltiti” Kosovën, ndërkaq, Krimesë i futi sanksione], <https://rs.sputniknews.com/rusija/202012171124130404-putin-zapad-progutaos-kosovo-a-krimu-uveo-sankcije/>.

³ Kremlin, Intervistë me televizionin austriak ORF, kanali 4, qershor 2018, <http://en.kremlin.ru/events/president/news/57675>.

Lidhur me këtë, duhet të vërehet se, për dallim nga aneksimi ilegal i Krimesë nga Rusia, të cilin Rusia u përpoq ta justifikonte përmes një referendumit që nuk u njoft ndërkombëtarisht, pavarësia e Kosovës ishte pasojë e heqjes së dhunshme të autonomisë federale të Kosovës në kuadër të Jugosllavisë më 1989–1990, dëbimit të popullatës shqiptare shumicë nga sektori publik, mizorive të zymta të kryera nga forcat ushtarake, paramilitare dhe policore të Beogradit (1998–1999), dhe procesit negocues të mandatuar nga KS KB, të udhëhequr nga Presidenti Ahtisaari, i cili përfundoi me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës që e dha zgjidhjen e pavarësisë së mbikëqyrur të Kosovës.⁴

Duhet po ashtu të vërehet se më 27 mars 2014, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara e përvetësoi Rezolutën 68/262,⁵ si përgjigje ndaj aneksimit rus të Krimesë. Kjo rezolutë, “E konfirmon përkushtimin e saj për sovranitetin, pavarësinë politike, unitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës në kuadër të kufijve të saj të pranuar ndërkombëtarisht; I thërret të gjitha shtetet t’i ndërpresin dhe të përmbahen nga veprimet që synojnë në përçarjen e plotë të unitetit kombëtar dhe të integritetit territorial të Ukrainës, përfshirë çfarëdo përpjekjesh për t’i modifikuar kufijtë e Ukrainës përmes kërcënimit apo shfrytëzimit të forcës apo përmes mjeteve të tjera të paligjshme.”⁶ Nga ana tjetër, Rezoluta 1244 (1999) e KS KB, e cila u përkrah edhe nga vetë Rusia, e shprehte përkushtimin e saj për ta zgjidhur situatën e zymtë humanitare në Kosovë, dhe e siguronte vendosjen e Administratës së KB në Kosovë dhe të Misionit të udhëhequr nga NATO-ja për Vendosjen e Paqes (Kosovo Force – KFOR).⁷ Për më tepër, më 22 korrik 2010, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GJND) e dha opinionin këshillues që konfirmonte se shpallja e pavarësisë së Kosovës me 17 shkurt, 2008, nuk e ka shkelur, as të drejtën ndërkombëtare, dhe as Rezolutën 1244 të KS KB.⁸

⁴ Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, 2 shkurt, 2007, <http://pbosnia.kentlaw.edu/Comprehensive%20Proposal%20for%20the%20Kosovo%20Settlement.pdf>.

⁵ Rezoluta e përvetësuar nga Asambleja e Përgjithshme, 27 mars 2014, https://www.un.org/en/ga/search/view_doc.asp?symbol=A/RES/68/262.

⁶ Ibid.

⁷ Rezoluta 1244(1999) e KS KB, 10 qershor 1999, https://peacemaker.un.org/sites/peacemaker.un.org/files/990610_SCR1244%281999%29.pdf.

⁸ PAJTIMI ME TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE I SHPALLJES SË NJËANSHME TË PAVARËSISË LIDHUR ME KOSOVËN, <https://www.icj-cij.org/public/files/case-related/141/141-20100722-ADV-01-00-EN.pdf>.

Lajmërim i Dezinformatës 2

Titulli: Сва злодела “Касапина” Вокера: Хоће ли албански плаћеник бити оптужен за ратне злочине [Të gjitha krimet e “kasapit” Walker: A do të akuzohet për krime lufte mercenari i shqiptarëve], **Sputnik Serbia, 24 dhjetor 2020.**⁹

Artikulli i transmeton deklaratat e Millovan Drecunit, udhëheqësit të komitetit parlamentar për Kosovën e Metohinë. Ai pohon se “Krimet e Walkerit gjithnjë duhen mbajtur ndër mend, dhe që ato nuk duhet të harrohen, dhe për to duhet të ushtrohet trysni e përhershme. Në një kohë në të ardhmen, ai duhet të përballet me përgjegjësinë për atë që ka bërë. Ai është përgjegjës se ishte bashkëpunëtor dhe bashkë-kryerës në një ndërmarrje të përbashkët kriminale, ashtu siç ajo u përkufizua në akuzën kundër Hashim Thaçit e të tjerëve, që u përpoqën ta grabisnin Kosovën me dhunë dhe t’i dëbonin serbët dhe jo-shqiptarët e tjerë”; “Pas kësaj, përgjegjësia e tij më e madhe është për bombardimin kriminal të vendit tonë, për shkak të masakrës imagjinare në fshatin Reçak, dhe fakti që ai si një mercenar shqiptar ka marrë pjesë në një spastrim etnik mizor.”

Dekonstruktimi i Dezinformatës: Fakte dhe Shifra

a) Masakra e Reçakut

Ndërkohë që përpiqet t’i mohojë krimet serbe gjatë luftës në Kosovë, Millovan Drecuni e akuzon ish-Ambasadorin e Shteteve të Bashkuara, dhe Kryesuesin e ish Misionit Verifikues në Kosovë, William Walker. Lidhur me pretendimin për “masakrën imagjinare,” duhet të vërehet se më 15 janar 1999 në fshatin Reçak në komunën e Shtimes, forcat policore dhe ushtarake serbe i kanë vrarë 45 qytetarë shqiptarë,¹⁰ dhe William Walkeri këtë veprim të forcave serbe e quajti si “krim kundër njerëzimit.”¹¹ Këto gjetje të tij u konfirmuan po ashtu edhe nga ekipi mjeko-ligjor

⁹ Сва злодела “Касапина” Вокера: Хоће ли албански плаћеник бити оптужен за ратне злочине [Të gjitha krimet e “kasapit” Walker: A do të akuzohet për krime lufte mercenari i shqiptarëve], <https://rs.sputniknews.com/analize/202012241124185596-sva-zlodela-kasapina-vokera-hoce-li-albanski-placenik-biti-optuzen-za-ratne-zlocine/>.

¹⁰ MASAKRA QË NDRYSHOI HISTORINË E KOSOVËS, <https://www.evropaelire.org/a/masakra-ge-ndryshoi-historine-e-kosoves/30376954.html>.

¹¹ Për më tepër, shih, <https://www.pbs.org/wgbh/pages/frontline/shows/kosovo/interviews/walker.html>.

finlandez, që u dërgua nga Bashkimi Evropian për hetimin e rastit në Reçak. Udhëheqësja e Ekipit Hetues Finlandez, Dr. Helen Ranta, pohoi se ata kishin ardhë në përfundim që viktimat kishin qenë qytetarë të paarmatosur, dhe edhe ajo këtë veprim e përshkroi si “krim kundër njerëzimit.”¹²

Lidhur me këtë, duhet vërejtur se masakra e Reçakut, njësoj si dhe dështimi në Marrëveshjen e Rambouillet-së, ishin pikat e kthesës në luftën në Kosovë, dhe këto në fund kulmuan me intervenimin e NATO-s.

b) Ndërrimi i narrativave për luftën në Kosovë dhe mohimi i krimeve të luftës së Serbisë

Artikulli flet për “spastrimin etnik” kundër serbëve dhe jo-shqiptarëve të tjerë të Kosovës, duke e shpërfillur në një mënyrë manipuluese faktin se kishin qenë ushtria jugosllave dhe policia dhe paramilitarët serbë ata që i kishin dëbuar 862.979 shqiptarë nga Kosova, ndërkohë që disa qindra mijëra të tjerë ishin të zhvendosur të brendshëm. Këto shifra tregojnë se deri heret në qershorin 1999, më shumë se 80 përqind e të tërë popullatës së Kosovës, dhe 90 përqind e të gjithë shqiptarëve kosovarë, ishin të zhvendosur nga shtëpitë e tyre.¹³ Nga ana tjetër, sipas regjistrimit të fundit jugosllav të vitit 1991, në Kosovë kanë qenë duke jetuar 194.000 serbë, ndërkohë që, bazuar në raportin e botuar nga Qendra Koordinuese e Qeverisë së Serbisë, në shkurtin e vitit 2002 në Kosovë kanë qenë duke jetuar 129,474 serbë. Prandaj, mund të përfundojmë se bazuar në këto shifra, Kosovën pas luftës e kanë braktisur një numër prej më së shumti 75,000 serbëve. Prandaj, deklarime të tilla si në këtë artikull janë në tërësi manipulative, dhe e kanë prirjen ta ndërrojnë narracionin për kryesit e krimeve dhe viktimave të tyre.

¹² Massacre a ‘crime against humanity’ in Kosovo [Masakra ‘krim kundër njerëzimit’ në Kosovë], <https://www.irishtimes.com/news/massacre-a-crime-againsthumanity-in-kosovo-1.164160>.

¹³ “Under Orders: War Crimes in Kosovo,” [Nën Urdhëra: Krimet e Luftës në Kosovë] Raport i Human Rights Watch, 2001, <https://www.hrw.org/report/2001/10/26/under-orders/war-crimes-kosovo>.

Lajmërim i Dezinformatës 3

Titulli: Dačić otkriva nepoznate detalje: Amerika nudila gašenje suda protiv OVK, Vučić odbio [Daçiqi zbulon hollësi të panjohura: Amerika ofroi mbylljen e gjyqit kundër UÇK-së, Vuçiqi refuzoi], **Sputnik Serbia, 12 dhjetor 2020.**¹⁴

Artikulli e transmeton deklaratën e Zëdhënësit të Parlamentit Serb, Ivica Daçiq, për Dhomat e Specializuara të Kosovës. Ai pohon rrejshëm se “Në përgatitjet për takim, Richard Grenell e vuri në dukje që njëra nga çështjet duhet të jetë që të gjithë duhet të punojmë së bashku për t’i shfuqizuar tribunalet e krimeve të luftës. E qartë, Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, refuzoi.” Për më tepër, ai pohoi se “shqiptarët kanë qenë duke punuar me administratën amerikane për rreth një viti për atë se si të shmangët kjo situatë me gjykimet e anëtarëve të UÇK-së.”

Dekonstruktimi i Dezinformatës: Fakte dhe Shifra

Pohimet e bëra nga Ivica Daçiq janë në tërësi të gabuara. Së pari, Dhomat e Specializuara të Kosovës janë formuar me votën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, kështu që kjo gjykatë është themeluar nga vetë Kosova. Së dyti, ka qenë posaçërisht administrata e Shteteve të Bashkuara ajo që vazhdimisht ka thirrur për themelimin e Dhomave të Specializuara të Kosovës, ndërkohë që Joe Biden i kishte dërguar letër ish Kryeministrit Hashim Thaçit, ku i thoshte se “e inkurajonte Kosovën për një bashkëpunim të plotë me Bashkimin Evropian për themelimin e Gjykatës Speciale për krimet e luftës.¹⁵ Për më tepër, pas publikimit të akuzës, Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara reagoi duke deklaruar se akuza ishte “një hap përpara në procesin e drejtësisë dhe të pajtimit në Ballkanin Perëndimor, që është thelbësor për përparimin e sundimit

¹⁴ Dačić otkriva nepoznate detalje: Amerika nudila gašenje suda protiv OVK, Vučić odbio [Daçiqi zbulon hollësi të panjohura: Amerika ofroi mbylljen e gjyqit kundër UÇK-së, Vuçiqi refuzoi], <https://rs-lat.sputniknews.com/vesti/202012121124075316-dacic-otkriva-nepoznate-detalle-amerika-nudila-gasenje-suda-protiv-ovk-vucic-odbio/>.

¹⁵ US vice President, letter to PM Thaçi: Kosovo must establish the Special Court on war crimes [Nënpresidenti i SHBA-ve, letër Kryeministrit Thaçi: Kosova duhet ta themelojë Gjykatën Speciale për krimet e luftës] <https://balkaneu.com/vice-president-letter-pm-thaci-kosovo-establish-special-court-war-crimes/>.

të ligjit dhe të drejtësisë për viktimat në Kosovë, si dhe për ta lëvizur vendin përtej kësaj periudhe të tmerrshme dhe drejt bashkimit me komunitetin Euro-Atlantik.¹⁶

Lidhur me deklaratën e Daçiqit për atë se njëra nga çështjet ishte “të shfuqizohen tribunalet për krimet ndërkombëtare të luftës,” duhet theksuar se nuk ka kurrfarë kufizimesh statutores që mund të zbatohen për krimet në vijim: gjenocidin, krimet e luftës, dhe krimet kundër njerëzimit.¹⁷

Lajmërim i Dezinformatës 4

Headline: Манастир Дечани међу 12 најугроженијих у Европи [Manastiri i Deçanit ndër 12 më të rrezikuarit në Evropë], **Sputnik Serbia, 9 dhjetor 2020.**¹⁸

Artikulli e nënvizon çështjen e manastirit të Deçanit në Kosovë, duke pohuar që organizata e shoqërisë civile Europa Nostra e ka radhitur atë ndër 12 objektet më të rrezikuara të trashëgimisë kulturore për vitin 2021. Artikulli, si dhe raporti nga Europa Nostra, pohojnë se “Është për keqardhje që sot manastiri i Deçanit, me trashëgiminë e vet kulturore dhe natyrore dhe me komunitetin e vet monastik, është shndërruar në peng të statusit të pazgjidhur të Kosovës. Që nga qershori 1999, Manastiri Deçani ka qenë nën mbrojtjen e trupave paqeruajtëse KFOR të udhëhequra nga NATO-ja. Edhe përkundërt kësaj, manastiri ka qenë shënjestër e katër sulmeve me mortaja nga ekstremistët lokalë gjatë periudhës 1999 deri në 2007, si dhe i një përpjekjeje për një sulm terrorist nga ISIS-ui në 2016. Në të njëjtën kohë, manastiri, me zonën e vet speciale mbrojtëse, është duke u përballur me kërcënime serioze mjedisore. Plani lokal komunal hapësinor nuk është në pajtim me rregullat e përpikta mbrojtëse për një Vend të Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s, dhe as me ligjet dhe rregulloret e ndërlidhura kombëtare. Është një rrezik

¹⁶ Kosovo President Hashim Thaçi Indicted on War Crimes Charges [Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi Paditet me Akuza për Krime të Luftës], <https://www.voanews.com/europe/kosovo-president-hashim-thaci-indicted-war-crimes-charges>.

¹⁷ Convention on the Non-Applicability of Statutory Limitations to War Crimes and Crimes Against Humanity [Konventa për Mos-Zbatueshmërinë e Kufizimeve Statutores për Krimet e Luftës dhe Krimet Kundër Njerëzimit], <https://web.archive.org/web/20120508073422/http://www2.ohchr.org/english/law/warcrimes.htm>.

¹⁸ Манастир Дечани међу 12 најугроженијих у Европи [Manastiri i Deçanit ndër 12 më të rrezikuarit në Evropë], <https://rs.sputniknews.com/vesti/202012101124060160-manastir-decani-medju-12-najugrozenijih-u-evropi/>.

i përhershëm i ndërtimit të objekteve urbane të papërshtatshme në afërsi të manastirit, si dhe rreziku i shpronësimit të tokës që i takon Manastirit të Deçanit. Posaçërisht i rrezikshëm është plani për ndërtimin e autostradës ndërkombëtare që do të kalonte fare pranë portës së manastirit.”

Dekonstruktimi i Dezinformatës: Fakte dhe Shifra

Para së gjithash, duhet vërejtur që Aneksi V i Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës e përcakton edhe çështjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore në Kosovë.¹⁹ Ky aneks përcakton se “Kishës Ortodokse Serbe (SOC) në Kosovë do t’i oftohet mbrojtja dhe gëzimi i të drejtave, privilegjeve dhe imuniteteve të saj, ashtu siç është parashtruar në këtë Aneks. Ushtrimi i të drejtave, privilegjeve dhe imuniteteve të tilla do t’i mbart me vete edhe detyrimet dhe përgjegjësitë për të vepruar në pajtim me ligjin e Kosovës, dhe nuk do t’i shkelë të drejtat e të tjerëve.”²⁰ Për më tepër, ky Aneks përcakton se “Një numër i zgjedhur i manastireve, kishave, dhe objekteve të tjera fetare të Kishës Ortodokse Serbe, si dhe i objekteve historike dhe kulturore të një rëndësie të veçantë për komunitetin serb të Kosovës, do ta kenë një mbrojtje të veçantë përmes themelimit të Zonave Mbrojtëse.”²¹ Dhe, ndër objektet e klasifikuara si zona të mbrojtura është pikërisht Manastiri i Deçanit. Lidhur me çështjen e sigurisë, është përcaktuar që “Kishës Ortodokse Serbe, manastireve, kishave dhe objekteve të tjera fetare e kulturore të saj të një rëndësie të veçantë për komunitetin serb të Kosovës duhet t’u ofrohet siguria e nevojshme.”²² Aneksi XII e përkufizon axhendën legislative, e cila e jep listën e ligjeve që Kuvendi i Kosovës duhet t’i miratojë gjatë periudhës tranzicionale 120-ditëshe, e cila e përfshinte, ndër të tjera, edhe Ligjin për Themelimin e Zonave të Mbrojtura.²³ Lidhur me këtë, duhet të vërehet se më 20 shkurt 2020, Kuvendi i Republikës së Kosovës e miratoi Ligjin për Zonat e Mbrojtura Speciale,²⁴ i cili i përfshin të gjitha të drejtat dhe obligimet e dhëna në Planin e Ahtisaarit. Prandaj, duhet të

¹⁹ Comprehensive Proposal For the Kosovo Status Settlement [Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës], <http://www.kosovocompromise.com/2008/pdf/Ahtisaaris-Proposal-full-version.pdf>.

²⁰ Ibid, Aneksi V, Neni 1 [Emri, Organizimi i Brendshëm dhe Prona e Kishës Ortodokse Serbe].

²¹ Ibid, Aneksi V, Neni 4 [Zonat e Mbrojtura].

²² Ibid, Aneksi V, Neni 3 [Siguria për Objektet Fetare dhe Kulturore].

²³ Ibid, Aneksi XII, Neni 1.

²⁴ LIGJI PËR ZONAT E VEÇANTA TË MBROJTURA, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2529>.

vërehet që Kisha Ortodokse Serbe dhe Manastiri i Deçanit e gëzojnë mbrojtjen e veçantë, njësoj si dhe objektet e tjera fetare të përcaktuara me këtë ligji. Për më tepër, Manastiri i Deçanit është nën mbrojtjen ditore të forcave të KFOR-it. Pohimi i bërë në artikull, se në vitin 2016 ka qenë një sulm nga grupet terroriste të ISIS-it, nuk qëndron, dhe as nuk është konfirmuar nga forcat e KFOR-it, siguria shtetërore, apo bashkësia ndërkombëtare, ndërkohë që çështja e autostradës Deçan–Plavë tashmë është zgjidhur, me ndërmjetësimin e Ambasadorit të Italisë në Kosovë.²⁵

Lajmërim i Dezinformatës 5

Titulli: “Kosovo je mafijaska drzava:” Evropski poslanik жестоко критиковao Приштину [“Kosova është një shtet mafioz:” Deputeti evropian e kritikon rreptë Prishtinën], **Sputnik Serbia**, **10 dhjetor 2020.**²⁶

Artikulli i transmeton deklaratat e anëtarit francez të Parlamentit Evropian, Thierry Mariani. Ai pohon se “Kosova është një rajon i Serbisë i cili kurrë nuk u lejua të mbetej në duart e atyre që atë e udhëheqin sot. Prishtina i shfuqizon të drejtat themelore, sundimin e ligjit, funksionimin e institucioneve demokratike. Ka trafikim të njerëzve, ka trafikim të organeve. Kosova sot është plaga e kancerit në Ballkan.” Në fund të artikullit, ai e akuzon Von Cramon, duke pohuar se “Hashim Thaçi është akuzuar me krime të luftës, dhe Von Cramon madje as që e përmend këtë fakt.”

²⁵ Manastiri i Deçanit rrezikon të shpallet në mesin e 7 vendeve më të rrezikuara të trashëgimisë në Evropë, <https://telegrafi.com/manastiri-decanit-rrezikon-te-shpallet-ne-mesin-e-7-vendeve-te-rrezikuara-te-trashegimise-ne-evrope/>.

²⁶ „Kosovo je mafijaska drzava“: Evropski poslanik жестоко критиковao Приштину [“Kosova është një shtet mafioz:” Deputeti evropian e kritikon rreptë Prishtinën], <https://rs.sputniknews.com/politika/202012101124063082-kosovo-je-mafijaska-drzava-evropski-poslanik-zestoko-kritikovao-pristinu/>.

Dekonstruktimi i Dezinformatës: Fakte dhe Shifra

a) Kosova është e pavarur, jo një rajon i Serbisë

Anëtari francez i Parlamentit Evropian, Thierry Mariani pohon rrejtshëm se “Kosova është një rajon i Serbisë.” Kosova e ka shpallur pavarësinë e vet më 17 shkurt 2008, bazuar në Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, që e parashihte pavarësinë e mbikëqyrur për Kosovën.²⁷ Shpallja e pavarësisë ishte fryt i procesit negociator për statusin e Kosovës të mandatuar nga KB, të udhëhequr nga i Dërguari i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, Presidenti Marti Ahtisaari. Për më tepër, nuk ka madje as edhe një rezolutë të vetme të KB apo akt tjetër ndërkombëtar, që Kosovën në mënyrë eksplicite ia cakton Serbisë si të tillë; e vetmja Rezolutë që është në forcë (1244), Kosovën e njeh si pjesë të Republikës Federale të Jugosllavisë që nuk ekziston më. Duhet po ashtu të vërehet se Franca ishte ndër vendet e para që e kanë njohur Republikën e Kosovës si shtet të pavarur dhe sovran.²⁸

b) Nuk ka kurfarë dëshmish për trafikimin me organe njerëzore

Thierry Mariani pohon rrejtshëm se “Ka trafikim me njerëz, ka trafikim me organe.” Akuzat e tilla për herë të parë janë përmendur në Raportin e Dick Martyt që është botuar më 14 dhjetor 2010, dhe që është paraqitur para Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës më 7 janar 2011. Raporti pretendonte për “trajtim jonjerëzor të njerëzve dhe vrasje të të burgosurve me qëllim të heqjes dhe trafikimit të paligjshëm të organeve njerëzore në Kosovë nga anëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.” Mirëpo, deklarata e Clint Williamsonit, Kryeprokurorit të Task Forcës Speciale Hetuese të Bashkimit Evropian, e 29 korrikut 2014 thotë se ndjekja penale e shkeljeve të ndërlidhura me trafikimin e organeve njerëzore “kërkon nivel të dëshmimeve që ne deri më tash nuk e kemi siguruar.”²⁹ Nga ana tjetër, paditë kundër Thaçit, Veselit, Krasniqit dhe Selimit nuk

²⁷ Comprehensive Proposal for the Kosovo Status Settlement [Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës], https://web.archive.org/web/20091015082628/http://www.unosek.org/docref/Comprehensive_proposalenglish.pdf.

²⁸ France Recognises Kosovo [Franca e njeh Kosovën], <https://balkaninsight.com/2008/02/18/france-recognises-kosovo/>.

²⁹ Clint Williamson, “Statement of the Chief Prosecutor of the Special Investigative Task Force [Deklaratë e Kryeprokurorit të Task Forcës Speciale Hetuese],” Bruksel, Bashkimi Evropian, 29 korrik 2014.

përmendin fare akuza lidhur me trafikimin e organeve njerëzore. Deklarata e Zyres së Prokurorit të Specializuar (SPO) të Dhomave të Specializuara të Kosovës (KSC), e 5 nëntorit 2020, pohon qartë se “Padia, ashtu siç është konfirmuar, thotë se janë kryer krime të luftës të burgosjeve dhe ndalimeve të paligjshme dhe arbitrare, të trajtimit të vrazhdë, të torturës, dhe të vrasjeve si dhe krimet kundër njerëzimit të burgosjes, dhe veprimet të tjera çnjerëzore, torturë, vrasje, zhdukje të dhunshme të personave, dhe persekutime,”³⁰ mirëpo ajo nuk përmend fare trafikim të organeve njerëzore.

Lajmërim i Dezinformatës 6

Titulli: Шпанија на ивици политичког офсајда због Косова: Како играти против земље која не постоји [Spanja para një ofsajdi politik për shkak të Kosovës: Si të luhet kundër një vendi që nuk ekziston], **Sputnik Serbia, 9 dhjetor 2020.**³¹

Artikulli e nënvizon çështjen e shortit për grupet kualifikuese të Kupës Botërore në futboll, ku Kosova dhe Spanja janë tërhequr në të njëjtin grup. Gazetari sportit, Vlladimir Stanković, këtë e paraqet si një diletantizëm politik të UEFA-s dhe të FIFA-s. Ai pohon se “Spanja është në një problem tejet serioz për shkak të shortit për grupet kualifikuese të Kupës Botërore në futboll: Njëra nga zgjidhjet është të luhet në fusha neutrale, mirëpo grupi është përgjithësisht tejet i ngatërruar, sepse pos Spanjës, edhe dy vende të tjera në këtë grup kualifikues, Greqia dhe Gjeorgjia, nuk e kanë njohur Kosovën, pra, i tërë grupi pos Suedisë.”

³⁰ Press Release, Kosovo Specialist Chambers & Specialist Prosecutor's Office [Deklaratë për shtyp, Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar], <https://www.scp-ks.org/en/indictment-against-hashim-thaci-kadri-veseli-rexhep-selimi-and-jakup-krasniqi-confirmed-ksc-pre>.

³¹ Шпанија на ивици политичког офсајда због Косова: Како играти против земље која не постоји [Spanja para një ofsajdi politik për shkak të Kosovës: Si të luhet kundër një vendi që nuk ekziston], <https://rs.sputniknews.com/analize/202012091124051012-spanija-na-ivici-politickog-ofsajda-zbog-kosova-kako-igrati-protiv-zemlje-koja-ne-postoji/>.

Dekonstruktimi i Dezinformatës: Fakte dhe Shifra

Artikulli e ka prirjen që këtë çështje ta ngrisë si një problem tejet të madh, dhe ky po ashtu e akuzon UEFA-n dhe FIFA-n lidhur me shortin e Kosovës dhe të Spanjës në të njëjtin grup për kualifikimet për Kupën Botërore. Artikulli në titullin e vet Kosovës i referohet si “një vend që nuk ekziston.” Së pari duhet të vërehet se Kosova është një vend i pavarur, që është anëtare, si në UEFA,³² ashtu edhe në FIFA,³³ me të drejta të plota si edhe anëtarët e tjera. Së dyti, duhet të vërehet se madje edhe në të kaluarën, çështja e vendeve që nuk e kanë njohur Kosovën nuk ka paraqitur ndonjë problem të madh, duke marrë parasysh që Kosova kohëve të fundit i ka luajtur dy ndeshje me Greqinë. Së fundi, duhet të vërehet po ashtu që ndeshjet e Kosovës me Spanjën nuk janë të ndaluara dhe nuk paraqesin problem apo rrezik nga aspekti i luajtjes së ndeshjeve futbolistike. UEFA e ka dhënë listën e gjashtë “ndeshjeve të ndaluara të ekipeve” që duhet të ndalohen në garat evropiane: Ukraina kundër Ruisë (që nga 2014), Kosova kundër Serbisë (2016), Bosnjes e Hercegovinës (2016), dhe Ruisë (2019), Armenia kundër Azerbajxhanit (2010) dhe Spanja kundër Gjibraltarit (2013).³⁴

³² Kosovo becomes member of UEFA, paves way for FIFA application [Kosova bëhet anëtare e UEFA-s, hap rrugën për të aplikuar në FIFA], <https://www.reuters.com/article/uk-uefa-kosovo-idUKKCN0XU11D>.

³³ FIFA Admits Kosovo [FIFA e Pranon Kosovën], <https://balkaninsight.com/2016/05/14/friday-13th-lucky-day-for-kosovo-05-13-2016-1/>.

³⁴ EURO 2020: Why Serbia can't face Kosovo - and UEFA's other 'forbidden' matchups [EURO 2020p: Pse Serbia nuk bën të përballet me Kosovën – dhe ndeshjet e tjera “të ndaluara” të UEFA-s], <https://www.dw.com/en/euro-2020-why-serbia-cant-face-kosovo-and-uefas-other-forbidden-matchups/a-51338370>.